

## Ç'farë është dhuna shtëpiake?

" Dhuna Shtëpiake "është dhunë që zakonisht ndodh në shtëpi midis njerëzve të cilët:

- \* janë aktualisht, ose kanë qënë të martuar
  - \* kanë aktualisht, ose kanë patur një marrëdhënie të rëndësishme
  - \* jetojnë aktualisht, ose kanë jetuar, së bashku ose kanë lidhje gjaku.
- Megjithëse dhuna shfaqet shpesh në formën e dëmtimeve fizike, ajo mund të shfaqet edhe në formën e kërcënimeve, izolimit, keqtrajtimit emocional, abuzimit gojor, ose seksit të detyruar.

Nëse po vuani nga dhuna shtëpiake në shtëpinë tuaj, nuk jeni vetëm. Megjithëse dhuna shtëpiake është zakonisht e fshehur, ajo është tepër e shpeshtë dhe ka të ngjarë që prek shumë njerëz që njihni.

## Çfarë mund të bëj unë?

Ka shumë shërbime në dispozicion për t'ju ndihmuar që dhuna në shtëpinë tuaj të ndalojë: streha, spitale, polici, shërbime ligjore, dhe shërbime të komunitetit.

## A duhet të thërras policinë?

Nëse jeni në rrezik të menjëhershëm, dilni dhe kërkoni ndihmë. Nëse jeni në rrezik, por nuk mund të ikni, telefononi 911. Nëse dëshironi të ikni, policia do t'ju shoqërojë ju dhe fëmijët tuaj në një vend të sigurt.

Duhet të dini se dhuna shtëpiake është krim. Policia duhet ta arrestojë abuzuesin nëse janë të bindur se është kryer një krim. Nëse policia arreston abuzuesin tuaj, ka mundësi që ata të kontrollojnë gjendjen e tij/saj të imigracionit. Nëse abuzuesi gjendet pa dokumenta, ai/ajo mund të dorëzohet në Imigracion dhe së fundi të deportohet.

Në përgjithësi, policia nuk kontrollon statusin e imigrimit të viktimës. Nëse policia pyet në mënyrë të papërshtatshme për statusin tuaj, sipas ligjit, ju keni të drejtën të mos ua tregoni. Detyra e oficerit të policisë është të mbrojë ju dhe fëmijët tuaj nga dëmi, jo të kontrollojë statusin tuaj të imigrimit. Nëse flisni me policinë, kërkoni të përgatisin një raport. Është mirë të merrni emrin dhe numrin e distinktivit të çdo oficeri me të cilin flisni. Nëse oficeri nuk e flet gjuhën tuaj, gjeni dikë tjetër përveç fëmijës suaj apo abuzuesit që të përkthejë për ju. Nëse ju nuk gjeni ndonjë, oficerët e policisë duhet të kenë mundësi për të përdorur linjat e përkthimit.

Mos e lejoni asnjëherë oficerin e policisë të përdorë një Patrullë Kufiri për të përkthyer për ju.

## A duhet të largohem nga shtëpia nëse jam në rrezik?

Po.. Shkoni në shtëpinë e një miku ose në strehën për gra të abuzuara. Qëndrimi nëpër streha është zakonisht falas dhe atje do të ketë avokatë të cilët do t'ju ndihmojnë për të vendosur se çfarë do të bëni më pas. Ata do të kenë edhe informacionin e duhur për shërbimet e komunitetit që mund t'ju ndihmojnë. Mbajeni të fshehtë vendndodhjen tuaj.

## Po nëse mendoj se më duhet të largohem në të ardhmen?

Bëni një plan për tu larguar. Përgatitni një çantë të vogël me dokumentat e rëndësishme në të (ose së paku kopjet e dokumentave të tilla). Fshiheni këtë çantë në një vend të sigurt (ndoshta tek një mik) prej nga ku mund ta merrni shpejt.

## Çfarë duhet të marr me vete?

Bëni çdo përpjekje për të marrë fëmijët tuaj me vete. Është e dobishme nëse mund të sillni me vete dokumentat dhe informacionin e rëndësishëm, të tilla si:

- |   |   |
|---|---|
| * Patenta e shoferit  | * Çertifikata e Martesës  |
| * Kontrata qiraje dhe informacion për pronësinë e apartamentit, shtëpisë dhe makinës suaj.  | * Informacion çekingu dhe bankar  |
| * Çertifikata lindje për veten dhe fëmijët tuaj   | * Fletët e fundit të pagesës së rrogës (tuajat dhe të abuzuesit)  |
| * Raporte mjekësore dhe të policisë publike   | * Dokumente të asistencës   |
| * Karta të sigurimit social, viza, green karta apo dokumente imigracioni dhe pasaporta për veten dhe fëmijët tuaj                   | * Emri, numri i telefonit dhe adresa e ndokujt që e ka parë apo të cilit i keni folur mbi dhunën e abuzuesit. |
| * Kopje të green kartës apo kartës së imigracionit, kartës së sigurimit social, pasaportës dhe çertifikatës së lindjes së abuzuesit | * Rroba apo sende të tjera të dëmtuara si pasojë e dhunës së abuzuesit.                                       |
| * Fotografi të ndonjë dëmi fizik apo dëmtim prone të shkaktuar nga abuzuesi juaj  |   |

## Kam dëgjuar për Urdhëra të Mbrojtjes Personale. Çfarë bëjnë ato?

Një Urdhër i Mbrojtjes Personale (UMP) mund të ndalojë abuzuesin t'ju telefonojë, kontaktojë, apo sulmojë ju, fëmijët, ose anëtare të tjerë të familjes tuaj.

Nuk ka nevojë të jeni Qytetar/e i/e SH.B.A-së ose të jeni Banor i Përhershëm i Ligjshëm për të patur një Urdhër Mbrojtjeje. Nëse ju pyesin për informacion në lidhje me statusin tuaj të imigracionit ndërsa jeni duke hapur dosje për UMP, mos ju përgjigjuni këtyre pyetjeve. Kontaktoni një avokat ose jurist gjyqi për t'ju shoqëruar , ndërsa ri-hapni dosjen për UMP.

## Si do ta mbështes veten dhe fëmijët e mi nëse do të largohem nga shtëpia?

Ligje të reja kanë krijuar mënyra se si imigrantë të abuzuar dhe fëmijët e tyre mund të kualifikohen për përkrahje ligjore dhe publike dhe madje të marrin edhe autorizim për punë. Ju mund të përmbushni gjithashtu kriteret për të aplikuar për mbështetje ekonomike nga bashkëshorti juaj.

Një avokat mund t'ju ndihmojë të gjeni strehim të sigurt dhe ushqim në rast nevoje. Disa mund t'ju ndihmojnë madje të aplikoni për mbështetje publike ose të gjeni punë. Një avokat mund t'ju ndihmojë me nevojat tuaja të tjera duke ju vënë në kontakt me kompani që ofrojnë shërbime ligjore, shoqërore apo mjekësore.

## Po nëse jam rezident i ligjshëm ose refugjat?

Nëse jeni Banor i Përhershëm i Ligjshëm ose Refugjat/Azilant, statusi juaj i imigrimit nuk do të ndikohet nga ndarja ose divorci me abuzuesin tuaj. Ju keni status ligjor; abuzuesi juaj nuk ka fuqi t'ju deportojë. Është ide e mirë të mbani dokumente që tregojnë se martesa juaj ka qënë ligjore dhe jo për qëllime imigrimi (çertifikatë martesë, letra, fotografi, etj).

## Po nëse kam Leje Qëndrimi me Kusht?

Ju jeni Banor me Kusht nëse karta juaj e Rezidencës do të skadojë 2 vjet pasi e keni marrë atë. Nëse bashkëshorti juaj me Qytetari në SH.B.A. nuk do t'ju ndihmojë të hiqen kushtet nga rezidenca juaj, është e mundur të kërkoni dokument për heqje dore. Flisni me një avokat imigracioni menjëherë.

## Jam pa dokumenta. A mund ta lë burrin tim dhe të bëj divorc pa pësuar deportim?

Po-nëse nuk jeni në siguri, ikni tani. Nuk ju duhen dokumenta për të bërë divorc ose të kërkoni kujdestari ligjore mbi fëmijët. Por, meqënëse divorci mund të ndikojë të drejta të

### **Po nëse fëmijët e mi ose unë jemi pa dokumenta? Si mund të fitojmë rezidencën ligjore dhe autorizimin e punës?**

Nëse ju apo fëmijët tuaj keni pësuar “rrahje apo provuar mizori të tejskajshme” nga bashkëshorti juaj, dhe ai është qytetar ose Banor i Përhershëm i SH.B.A-së., ju mund të keni të drejtën për lehtësime nën ligjin e imigracionit. Akti i Dhunës Kundër Grave (VAWA) mund t’ju lejojë ju dhe fëmijët tuaj të bëni peticion për vete për residence të përhershme dhe leje pune pa nevojën e ndihmës nga abuzuesi juaj. Peticioni juaj është i fshehtë. CIS (më parë INS) nuk mund ta diskutojë rastin tuaj me abuzuesin dhe as nuk mund të marrë vendime kundër jush duke u bazuar vetëm në informacionin e dhënë nga bashkëshorti juaj. Ju mund të keni të drejtë edhe për përkrahje publike.

### **Kush mund të bëjë peticion për vete nënVAWA?**

- \* një bashkëshort i abuzuar i një Qytetari ose Banori të Përhershëm të SH.B.A-së.
- \* një fëmijë i abuzuar i një Qytetari ose Banori të Përhershëm të SH.B.A-së.
- \* prindi i një fëmije që është abuzuar dhe/apo ka pësuar mizori emocionale të pamasë nga një prind me qytetari apo Rezidencë të Përhershme në Sh.B.A., në rast se prindërit janë të martuar.

### **Po nëse e kam divorcuar abuzuesin?**

Mund ta keni akoma të mundur të bëni një peticion për veten nëse jeni divorcuar më pak se 2 vjet më parë. Duhet të flisni menjëherë me një avokat imigracioni.

### **Po nëse nuk jam e martuar me abuzuesin? Po nëse abuzuesi është edhe ai pa dokumenta?**

Nëse jeni viktimë e një krimi të kryer nga partneri juaj apo një palë tjetër, përsëri ju mund të keni të drejtën për vizën U. Që të klasifikoheni për këtë vizë nuk ka nevojë që bashkëshorti juaj të jetë Qytetar ose Banor i Përhershëm i SH.B.A-së. Kjo vizë mund të ndihmojë edhe individët që nuk janë të martuar ligjërisht me partnerët e tyre intimë. Kjo vizë kërkon nga ju të bashkëpunoni me forcat e policisë gjatë hetimit të krimit kundër jush. Duhet të kontaktoni një avokat për të parë nëse kualifikoni për këtë lloj vize.

tjera, mos bëni divorc pa folur më parë me një avokat imigracioni.

### **Po nëse deportohem?**

Nëse jeni në procedurë e sipër për deportim apo dëbim, mund të keni të drejtën për disa forma lehtësime duke përfshirë "anullimin e dëbimit". Ju duhet të flisni menjëherë me një avokat imigracioni. Mos firmosni asnjë letër që thotë se keni rënë dakort për tu larguar vullnetarisht pa biseduar më parë me një avokat.

### **Po nëse abuzuesi deportohet?**

Ju dhe fëmijët tuaj mund të keni akoma mundësi të bëni peticion për veten. Duhet të flisni menjëherë me një avokat imigracioni.

### **Po nëse abuzuesi është prindi im?**

Fëmijët e pamartuar nën 21 vjeç, të abuzuar nga një prind, i cili është qytetar i SH.B.A. ose Banor i Përhershëm mund të aplikojnë për status imigracioni nën VAWA.

### **A mundet një burrë të bëjë peticion për vete nën VAWA?**

Po. Një burrë i abuzuar ka të njëjtat të drejta nën VAWA.

### **A kam nevojë për një avokat imigracioni?**

Ndoshta- Avokati i imigracionit do të jetë në gjendje të përcaktojë nëse ju mund të bëni peticion për vete dhe mund t’ju ndihmojë me aplikimin. Mos shkoni nëpër shërbimet e Qytetarisë dhe Imigracionit pa folur më parë me një avokat imigracioni! Biseda juaj me këtë avokat do të jetë e fshehtë. Ai ose ajo **nuk mund** t’ju raportojë tek Imigracioni. Shumë zyra ndihme ligjore ofrojnë shërbime falas ose me çmime të ulta. Disa janë të specializuara në çështjet e grave të abuzuara.

*Ky projekt pati përkrahjen e Fondit me Numër. 2004-WL-AX-0032 të dhuruar nga Office of Violence Against Women, U.S. Department of Justice – Zyra e Dhunës Kundër Grave. Departamenti i Drejtësisë së Sh.B.A-së. Opinione, zbulimet, përfundimet dhe rekomandimet e shprehura në këtë botim/ program/ekspozitë janë të autorit (autorëve) dhe nuk pasqyrojnë detyrimisht pikëpamjet e Department of Justice, Office of Violence Against Women – Departamentit të Drejtësisë, Zyra e Dhunës Kundër Grave.*

LAKESHORE LEGAL AID  
CENTRAL INTAKE

TELEFONONI FALAS: 1-888-783-8190


Ju keni të drejtën të jetoni pa dhunë në shtëpinë tuaj.

## **PYETJE DHE PËRGGJIGJE**

### **MBI DHUNËN SHTËPIAKE PËR IMIGRANTËT GRA, BURRA DHE FËMIJË PA DOKUMENTA**

A ju ka kërcënuar abuzuesi juaj se do t’ju deportojë ju apo fëmijët tuaj nëse ju telefononi për ndihmë apo ia raportoni abuzimin policisë?

Kjo broshurë do t’ju tregojë se si t’i ndërmerrni hapat për tu ruajtur nga dhuna dhe ndoshta edhe për të marrë rezidencën ligjore dhe autorizimin e punës.



LAKESHORE LEGAL AID

ST. CLAIR COUNTY OFFICE

803 Tenth Avenue, Ste. C

Port Huron, MI 48060

(810) 985-5107

MACOMB OFFICE

21885 Dunham Road, Ste. 4

Clinton Township, MI 48036

(586) 469-6522

CENTRAL INTAKE

**TELEFONONI FALAS: 1-888-783-8190**